



Operatori i Sistemit të Transmetimit

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: OE “Grant Thornton” sh.p.k., me NIPT K91923007M,
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, Kompleksi “T.I.D”, Hyrja B,
Kati 1, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “E hapur e thjeshtuar” me mjete elektronike – Shërbime.

Numri i referencës së procedurës: REF-44789-10-07-2022

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Auditimi nga një shoqëri e pavarur audituese i Pasqyrave Financiare të konsoliduara të OST sh.a. për vitin 2022 sipas Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit”.

Kohëzgjatja e kontratës: 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Data 17.10.2022, Nr. 143.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në çmim.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE “Public Accounting Service Union and Trust” sh.p.k. me NIPT L21423032S
“Eljona Hoxha” p.f. me NIPT M12213005N
Vlera 1,190,000 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.
2. OE “Grant Thornton” sh.p.k. me NIPT K91923007M
Vlera 1,250,000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.
3. OE “Rajmonda Reveli” p.f. me NIPT L01529006O
Pa ofertë ekonomike.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE “Public Accounting Service Union and Trust” sh.p.k., me NIPT L21423032S & “Eljona Hoxha” p.f., me NIPT M12213005N, për arsye se:

- Nuk ka plotësuar në mënyrë të duhur Shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, pasi nuk janë shënuar të gjithë anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por vetëm njëri.
- Nuk ka përmbushur kriterin 1/b, të Shtojcës 8, pika 2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të DST, pasi nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas kërkesës së nenit 83, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe sipas përcaktimit të pikës 3.1 të Njoftimit të Kontratës, në Dokumentet e Tenderit.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.2.1 të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pasi nuk ka paraqitur kopje të certifikuara të bilanceve, të nevojshme për të vërtetuar se në të paktën dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.6 të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pasi nuk ka paraqitur listën e firmave audituese të Bankës Botërore (Eligible audit firms) në të cilën duhet të jetë i përfshirë BOE me statusin Fully Acceptable.

2. OE “Rajmonda Reveli” p.f., me NIPT L01529006O, për arsye se:

- Nuk ka paraqitur asnjë dokument të kërkuar në Dokumentet e Tenderit, përfshirë ofertën ekonomike sipas udhëzimeve të DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “Grant Thornton” sh.p.k. me NIPT K91923007M**, Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, Kompleksi “T.I.D”, Hyrja B, Kati 1, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerën **1,250,000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.

ADMINISTRATORI I OST SH.A.

Skerdi Drenova